



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria –Vlada-Government*

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

DEPARTAMENTI PËR POLITIKA SOCIALE DHE TË FAMILJES

DIVIZIONI PËR PLANIFIKIM DHE PËRFSHIRJE SOCIALE

# SKEMAT DHE PROGRAMET E MBROJTJES SOCIALE TË DPSF-së



KORRIK-SHTATOR 2021

TETOR 2021

<b>Autore</b>	<b>Ylfete Ramosaj-Abazi</b> , Zyrtare e lartë për të dhëna dhe statistika Divizioni për Planifikim dhe Përfshirje Sociale DPSF/MFPT <a href="mailto:ylfete.ramosaj@rks-gov.net">ylfete.ramosaj@rks-gov.net</a>
<b>Përgjegjës</b>	<b>Mentor Morina</b> , Udhëheqës Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes/MFPT <a href="mailto:mentor.morina@rks-gov.net">mentor.morina@rks-gov.net</a>
<b>Adresa</b>	Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes/MFPT Rr. UÇK-së Nr.1 10000 Prishtinë, Kosovë

## LISTA E FIGURAVE

---

<b>Figura 1: Numri i familjeve në SNS, korrik-shtator 2021.....</b>	<b>7</b>
Figura 2: Numri i anëtarëve të familjes përfitues të ndihmës sociale, korrik-shtator 2020.....	8
Figura 3: Familjet/bartësit e lëndës sipas kategorive, korrik-shtator 2021.....	9
Figura 4: Anëtarët e familjes në ndihmë sociale sipas kategorive, korrik-shtator 2021.....	10
Figura 5: Përfituesit e ndihmës sociale sipas gjinisë, shtator 2021.....	10
Figura 6: Përfituesit e ndihmës sociale sipas gjinisë, shtator 2021.....	11
Figura 7: Përfituesit e ndihmës sociale me përqindje sipas gjinisë, shtator 2021.....	11
Figura 8: Përfituesit e ndihmës sociale, sipas përkatësisë etnike, shtator 2021.....	12
Figura 9: Numri i anëtarëve në SNS sipas përkatësisë etnike, shtator 2021.....	13
Figura 10: Buxheti i shpenzuar për Skemën e FFAKP-së, periudha korrik-shtator 2021.....	13
<b>Figura 11: Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së, korrik-shtator 2021.....</b>	<b>15</b>
Figura 12: Përfituesit e Skemës së FFAKP-së sipas gjinisë, shtator 2021.....	16
Figura 13: Përfituesit e Skemës së FFAKP-së sipas moshës, shtator 2021.....	16
Figura 14: Përfituesit e Skemës së FFAKP-së sipas moshës, shtator 2021.....	17
Figura 15: Buxheti i shpenzuar për Skemën e FFAKP-së, periudha korrik-shtator 2021.....	17
<b>Figura 16: Fëmijët dhe familjet në Strehim familjar brenda familjes biologjike, korrik-shtator 2021.....</b>	<b>19</b>
Figura 17: Buxheti i shpenzuar për Strehim familjar brenda familjes, korrik-shtator 2021.....	19
Figura 18: Numri i fëmijëve dhe i familjeve strehuese korrik-shtator 2021.....	20
Figura 19: Buxheti i shpenzuar për Strehim familjar jashtë familjes, korrik-shtator 2021.....	21
<b>Figura 20: Kërkesat e shqyrtuara për ndihmë të njehershme, korrik-shtator 2021.....</b>	<b>22</b>
Figura 21: Kërkesat për ndihmë të njehershme të aprovuara/refuzuar, korrik-shtator 2021.....	23
Figura 22: Buxheti i shpenzuar për Ndhim të njehershme, korrik-shtator 2021.....	24

## LISTA E TABELAVE

---

Tabela 1: Përfituesit e ndihmës sociale, sipas etnitetit, shtator 2021.....	11
---	----

# PËRMBAJTJA

---

<b>HYRJE</b> .....	<b>5</b>
<b>1. SKEMA E NDIHMËS SOCIALE</b> .....	<b>6</b>
1.1. Kriteret për përfitimin e ndihmës sociale.....	6
1.2. Numri i familjeve në Skemën e Ndhmës Sociale.....	6
1.2.1. Numri i anëtarëve të familjes në Skemën e Ndhmës Sociale.....	7
1.2.2. Familjet/bartësit e lëndës sipas kategorisë.....	7
1.2.3. Anëtarët e familjes sipas kategorisë.....	8
1.2.4. Përfituesit e ndihmës sociale sipas gjinisë.....	9
1.2.5. Përfituesit e ndihmës sociale sipas moshës.....	10
1.2.6. Përfituesit e ndihmës sociale sipas përkatësisë etnike.....	11
1.2.7. Buxheti i shpenzuar, korrik-shtator 2021.....	12
<b>2. SKEMA PËR PËRKRAHJEN MATERIALE TË FAMILJEVE ME FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË PËRHERSHME</b> .....	<b>13</b>
2.1. Kriteret për të përfituar nga Skema e FFAKP-së.....	13
2.2. Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së.....	13
2.2.1. Përfituesit e Skemës së FFAKP-së sipas gjinisë.....	14
2.2.2. Përfituesit e Skemës së FFAKP-së sipas moshës.....	14
2.2.3. Buxheti i shpenzuar, korrik-shtator 2021.....	15
<b>3. STREHIMI FAMILJAR</b> .....	<b>16</b>
3.1. Format e strehimit familjar.....	16
3.2. Strehimi familjar brenda familjes biologjike.....	16
3.2.1. Numri i fëmijëve në strehim familjar brenda familjes biologjike.....	16
3.2.2. Buxheti i shpenzuar për strehim familjar brenda familjes biologjike.....	17
3.3. Strehimi familjar jashtë familjes biologjike.....	18
3.3.1. Numri i fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes biologjike.....	18
3.3.2. Buxheti i shpenzuar, korrik-shtator 2021.....	19
<b>4. NDIHMAT E NJËHERSHME/EMERGJENTE</b> .....	<b>20</b>
4.1. Kriteret për përfitimin e Ndhmës së Njëhershme/Emergjente.....	20
4.2. Numri i kërkesave të shqyrtuara, korrik-shtator 2021.....	20
4.2.1. Buxheti i shpenzuar, korrik-shtator 2021.....	21

# HYRJE

---

Mandatin për menaxhimin e skemave sociale si: Skema e Ndhmës Sociale dhe Skema për Përkrahjen Materiale të Familjeve të Fëmijëve më Aftësi të Kufizuara të Përhershme, dhe të programeve të mbrojtjes sociale si: Strehimi familjar brenda familjes biologjike, Strehimi familjar jashtë familjes biologjike dhe të Ndhmave të njehershme/ emergjente, e ka Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes (DPSF), i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve/MFPT.<sup>1</sup>

Andaj, ky Raport statistikor ofron të dhëna statistikore për përfituesit e këtyre skemave sociale dhe programeve të mbrojtjes sociale për periudhën korrik-shtator 2021. Gjithashtu, në raport është paraqitur edhe diferenca e numrit të përfituesve të këtyre skemave dhe programeve të mbrojtjes sociale të muajit shtator 2021 me atë të muajit të njëjtë të vitit paraprak, si dhe diferenca e buxhetit të shpenzuar për periudhën korrik-shtator 2021 me periudhën e njëjtë të vitit 2020.

Për hartimin e këtij raporti janë përdorur të dhënat nga Divizioni i Ndhmave Sociale (DNS), Divizioni i Shërbimeve Sociale (DSHS) dhe Divizioni për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar (DAKPM).

---

<sup>1</sup> **Sqarim:** DPSF-ja më herët ka vepruar në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Mirëpo, me formimin e Qeverisë së re (shkurt 2021) ka kaluar në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

# 1. SKEMA E NDIHMËS SOCIALE

## 1.1. Kriteret për përfitimin e Ndihmës Sociale

Për të realizuar të drejtën në ndihmë sociale të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës (përjashtimisht edhe shtetas të huaj të cilët: a) kanë leje qëndrimi; b) personat në cilësinë e azilkërkuesit; c) personat në cilësinë e refugjatit dhe d) personat të cilët gëzojnë mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese), dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërin prej kategorive vijuese:


**Kategoria e parë** - familja në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar, dhe

**Kategoria e dytë** - familja me një anëtar të aftë për punë, me të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare, apo që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën 15 vjeç.<sup>2</sup>

## 1.2. Numri i familjeve në Skemën e Ndihmës Sociale

Gjatë periudhës raportuese, del që në muajin korrik 2021 është shënuar numri më i madh i familjeve në ndihmë sociale. Këtë muaj kanë përfituar 25.714 familje, 176 familje apo 1% më shumë se në muajin gusht dhe 200 familje apo 1% më shumë se në muajin shtator. Shih Figurën më poshtë:

Figura 1: Numri i familjeve në SNS, korrik-shtator 2021




<sup>2</sup> Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë dhe Ligji Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.

Diferenca e numrit të familjeve, shtator 2021, me muajin e njëjtë të vitit paraprak është 1.018 familje apo 4% më shumë.

### 1.2.1. Numri i anëtarëve të familjes në Skemën e Ndhmës Sociale

Numri i anëtarëve të familjes, përfitues të ndihmës sociale, gjatë kësaj periudhë ka ndryshuar. Në muajin korrik 2021 është shënuar numri më i madh i anëtarëve të familjes të përfshirë në SNS. Këtë muaj kanë përfituar 102.371 anëtarë, 690 anëtarë apo 1% më shumë se në muajin gusht dhe 750 familje apo 1% më shumë se në muajin shtator. Shih figurën më poshtë:

Figura 2: Numri i anëtarëve të familjes përfitues të ndihmës sociale, korrik-shtator 2020



Diferenca e numrit të anëtarëve të familjes, shtator 2021, me muajin e njëjtë të vitit paraprak është 2,631 anëtarë apo 3% më shumë.

### 1.2.2. Familjet/bartësit e lëndës sipas kategorisë


Në kategorinë I, gjatë periudhës raportuese kanë qenë mesatarisht 18.244 familje apo 71% e totalit të familjeve në SNS, ndërsa në kategorinë II, mesatarisht kanë qenë 7.344 familje apo 21% e totalit të familjeve në SNS.

Numri më i madh i familjeve në kategorinë I është shënuar në muajin korrik, 18.272 familje, 43 familje apo 0.24% më shumë se në muajin gusht dhe 40 familje apo 0.22% më shumë se në muajin shtator. Pra, numri i familjeve në kategorinë I, në muajin shtator 2021 ka rënë për 40 familje më pak apo -0.22% në krahasim me muajin korrik 2021.

Edhe në kategorinë II, numri më i madh i familjeve është shënuar në muajin korrik, 7.442 familje, 133 familje apo 2% më shumë se në muajin gusht dhe 160 familje apo 2% më shumë se në muajin shtator. Pra,

numri i familjeve në kategorinë II, në muajin shtator 2021 ka rënë për 160 familje më pak apo -2% në krahasim me muajin korrik 2021. Shih tabelën më poshtë:

Figura 3. Familjet/bartësit e lëndës sipas kategorive, korrik-shtator 2021



Diferenca e numrit të familjeve/bartësve të lëndës në kategorinë I, shtator 2021, me muajin e njëjtë të vitit paraprak është 1.177 familje apo 7% më shumë. Ndërsa diferenca e numrit të familjeve/bartësve të lëndës në kategorinë II, shtator 2021, me muajin e njëjtë të vitit paraprak është 159 familje më pak apo -2%.

### 1.2.3. Anëtarët e familjes sipas kategorisë


Në kategorinë I, gjatë periudhës raportuese kanë qenë mesatarisht 48.088 anëtarë apo 63% e totalit të anëtarëve familjes në SNS, ndërsa në kategorinë II, mesatarisht kanë qenë 28.192 anëtarë apo 37% e totalit të anëtarëve në SNS.

Në muajin shtator 2021 kemi një rritje të numrit të anëtarëve të familjes për 79 anëtarë apo 0.16% më shumë se në muajin gusht dhe 15 anëtarë apo 0.03% më shumë se në muajin korrik.

Edhe në kategorinë II, në muajin shtator 2021 kemi një rritje të numrit të anëtarëve të familjes për 439 anëtarë apo 2% më shumë se në muajin gusht dhe 552 anëtarë apo 2% më shumë se në muajin korrik. Shih tabelën më poshtë:



Figura 4. Anëtarët e familjes në ndihmë sociale sipas kategorive, korrik-shtator 2021




Diferenca e numrit të anëtarëve të familjes në kategorinë I, shtator 2021, me muajin e njëjtë të vitit paraprak është 2.322 anëtarë apo 5% më shumë. Ndërsa diferenca e numrit të anëtarëve të familjes në kategorinë II, shtator 2021, me muajin e njëjtë të vitit paraprak është 224 anëtarë apo -1% më pak.

#### 1.2.4. Përfituesit e ndihmës sociale sipas gjinisë

Sa i përket strukturës gjinore, në shtator 2021, 52.314 përfitues të ndihmës sociale apo 51% ishin femra, ndërsa 49.307 përfitues apo 49% ishin meshkuj. Pra, kemi një diferencë prej 3.007 apo 6% më shumë femra se sa meshkuj përfitues në SNS. Shih figurën më poshtë:

Figura 5: Përfituesit e ndihmës sociale sipas gjinisë, shtator 2021



### 1.2.5. Përfituesit e ndihmës sociale sipas moshës

Bazuar në moshën e përfituesve të Skemës së SNS-së të muajit shtator 2021, del që numri më madh i përfituesve i takon grup-moshës 19-65 vjeç, me 51,381 përfitues apo 34% të totalit të përgjithshëm të përfituesve të SNS, pastaj grup-moshës 0-18 vjeç, me 49,131 përfitues apo 48% dhe numri më i vogël grup-moshës mbi 65 vjeç, me 1,109 përfitues apo 1% e totalit të përgjithshëm. Shih figurat më poshtë:

Figura 6: Përfituesit e ndihmës sociale sipas gjinisë, shtator 2021





Figura 7: Përfituesit e ndihmës sociale me përqindje sipas gjinisë, shtator 2021




1.2.6. Përfituesit e ndihmës sociale sipas përkatësisë etnike

Bazuar në strukturën etnike të familjeve/bartësve të lëndës del që: 19,173 familje janë shqiptare apo 75% e numrit total të familjeve në ndihmë sociale dhe 6.341 familje/bartës të lëndës janë të komuniteteve të tjera apo 25% e numrit total të familjeve në ndihmë sociale. Shih tabelën dhe figurat më poshtë:

Tabela 1: Përfituesit e ndihmës sociale, sipas etnitetit, shtator 2021


Etniteti	Numri i familjeve/bartësve	Numri i anëtarëve të familjes
Shqiptarë	19,173	79,142
Serb	2,786	6,957
Rom	1,012	4,523
Ashkali	1,487	7,103
Egjiptian	428	2,082
Turk	69	210
Boshnjak	240	699
Malazez	3	9
Kroat	13	33
Goran	215	614
Të tjera-	88	249
<b>Totali</b>	<b>25,514</b>	<b>101,621</b>

Figura 8: Përfituesit e ndihmës sociale, sipas etnitetit, shtator 2021



Sa i përketë numrit të anëtarëve të familjes del që 79.142 anëtarë janë shqiptarë apo 78% e numrit total, ndërsa 22,479 anëtarë janë të komuniteteve të tjera apo 22% e numrit total. Shih Figurën më poshtë:


Figura 9: Numri i anëtarëve në SNS sipas etnitetit, shtator 2021



### 1.2.7. Buxheti i shpenzuar, korrik-shtator 2021

Për periudhën raportuese janë shpenzuar 10,224,710.25 euro. Në muajin korrik 2021 është procesuar shuma me e madhe e mjeteve, 3,424,733.00 euro apo 33% e shumës totale të buxhetit. Këtë muaj janë procesuar, 24,812.25 euro apo 1% më shumë se në muajin gusht dhe 24,676.50 euro më shumë apo 1% më shumë se sa në muajin shtator 2021. Pra, në muajin shtator kemi një rënie prej 24,676.50 euro apo 1% se në muajin korrik 2021. Shih figurën më poshtë:

Figura 10: Buxheti i shpenzuar për Skemën e SNS-së, korrik-shtator 2021



Diferenca e buxhetit të shpenzuar korrik-shtator 2021, me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është 2,495,032.75 euro më shumë apo 32%.<sup>3</sup>

<sup>3</sup> **Sqarim:** kjo rritje e mjeteve, arsyetohet me faktin se të gjitha familjet përfituese të SNS, gjatë muajve korrik-shtator 2021 kanë përfituar edhe një shtesë prej 30% të shumës bazë të ndihmës sociale. Kjo shtesë është bërë me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si pjesë e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike.

## 2. SKEMA PËR PËRKRAHJEN MATERIALE TË FAMILJEVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË PËRHERSHME


### 2.1. Kriteret për të përfituar nga Skema e FFAKP-së

Sipas legjislacionit në fuqi, fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme u takon ndihma dhe kujdesi për plotësimin e aktiviteteve të përditshme jetësore. Që të lëvizin dhe t'i kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore në mënyrë të pavarur, për këta persona është i nevojshëm kujdesi i huaj 24 orësh.<sup>4</sup> Shuma mujore për një fëmijë është 100 euro në muaj dhe bëhet përmes llogarive bankare.

### 2.2. Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së

Gjatë periudhës raportuese, numri i fëmijëve që kanë përfituar nga Skema e FFAKP-së, ka ndryshuar nga muaji në muaj. Në muajin gusht 2021 është shënuar numri më i madh i fëmijëve përfitues, ku në këtë muaj kanë përfituar 2.546 fëmijë, 80 fëmijë apo 3% më shumë se në muajin korrik dhe 25 fëmijë apo 1% më shumë se në muajin shtator. Pra, në muajin shtator 2021 kemi një rritje të numrit të fëmijëve për 55 fëmijë apo 0.02% më shumë në krahasim me muajin korrik 2021. Shih figurën më poshtë:

Figura 11: Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së, korrik-shtator 2021




<sup>4</sup> Neni 5 i Ligjit Nr. 03/L-022 për Përkrahjen Materiale të Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme

Diferenca e fëmijëve përfitues të FFAKP-së, shtator 2021, me muajin e njëjtë të vitit paraprak (shtator 2020-2.333 fëmijë), është 1,100 euro më shumë apo 38%.

### 2.2.1. Përfituesit e Skemës së FFAKP-së sipas gjinisë

Në shtator 2021, 986 fëmijë apo 39% ishin vajza, ndërsa e 1.535 fëmijë apo 61% ishin djem. Pra, kemi një diferencë prej 549 djemve më shumë apo 56% në krahasim me vajza. Shih figurën më poshtë:

Figura 12: Përfituesit e Skemës së FFAKP-së sipas gjinisë, shtator 2021



### 2.2.2. Përfituesit e Skemës së FFAKP-së sipas moshës

Në muajin shtator 2021, numri më madh i fëmijëve i takon grup-moshës 8-12 vjeç, 865 fëmijë apo 34% e totalit të përgjithshëm dhe numri më i vogël grup-moshës 0-3 vjeç, 104 fëmijë apo 4% e totalit të përgjithshëm. Shih figurat më poshtë:

Figura 13: Përfituesit e Skemës së FFAKP-së sipas moshës, shtator 2021






Figura 14: Përfituesit e Skemës së FFAKP-së sipas moshës, shtator 2021



### 2.2.3. Buxheti i shpenzuar, korrik-shtator 2021

Gjatë periudhës raportuese buxheti i shpenzuar për Skemën e FFAKP-së është 791,700.00 euro. Në muajin gusht 2021 është procesuar shuma më e madhe e mjeteve, 289 mijë euro apo 37% e totalit të përgjithshëm. Këtë muaj janë procesuar 39,400 euro apo 16% më shumë se në muajin korrik dhe 35,900 euro apo 14% më shumë se në muajin shtator 2021. Diferenca e mjeteve të procesuara në muajin shtator 2021, me muajin korrik është 3,500 euro apo 1% më shumë. Shih figurën më poshtë:

Figura 15: Buxheti i shpenzuar për Skemën e FFAKP-së, periudha korrik-shtator 2021



Diferenca e buxhetit të shpenzuar korrik-shtator 2021, me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është 68,000 euro më shumë 10%.

## 3. STREHIMI FAMILJAR

---

### 3.1. Format e strehimit familjar

Është formë alternative e mbrojtjes sociale për fëmijët pa kujdes prindëror, të keqtrajtuar dhe të lënë pas dore. Kjo formë e mbrojtjes nënkupton vendosjen e përkohshme të fëmijës në familje tjetër atëherë kur qëndrimi i fëmijës në familjen biologjike është i pamundur.<sup>5</sup> Bazuar në legjislacionin në fuqi, strehimi familjar realizohet në dy forma:

1. Strehimi familjar brenda familjes biologjike, dhe
2. Strehimi familjar jashtë familjes biologjike.

### 3.2. Strehimi familjar brenda familjes biologjike

**Strehimi familjar brenda familjes biologjike nënkupton strehimin e fëmijës në familje me lidhje fisnore.**<sup>6</sup> Kjo formë e mbrojtjes sociale, iu ofrohet fëmijëve të braktisur e pa kujdes prindëror (fëmijëve të lënë pas dore, të keqtrajtuar, të prindërve të penguar në ushtrimin e detyrës prindërore, apo rasteve të tjera kur cenohet interesi dhe mirëqenia e fëmijës/ve). Familje strehuese nga farefisi konsiderohen të afërmit e fëmijës që në mënyrë vullnetare kanë pranuar mbikëqyrjen dhe strehimin e fëmijës/ve pa kujdes prindëror, prindërit e të cilëve përkohësisht apo në mënyrë të përhershme nuk janë në gjendje që të ushtrjnë detyrat e tyre prindërore.

Shuma e pagesës për një fëmijë në strehim familjar është 100.00 euro në muaj, pagesa bëhet në emër të kujdestarit të fëmijës së strehuar dhe realizohet përmes llogarisë bankare.

#### 3.2.1. Numri i fëmijëve në strehim familjar brenda familjes biologjike

Gjatë periudhës raportuese, numri i fëmijëve në Strehim familjar brenda familjes biologjike nuk ka lëvizur shumë. Në muajin shtator 2021 kemi 436 fëmijë të vendosur në 318 familje strehuese, pra këtë muaj kemi 1 fëmijë më shumë se në muajin korrik dhe në muajin gusht 2021. Shih figurën më poshtë:


---

<sup>5</sup> Neni 3, pika 1.9, Udhëzim Administrativ (MPMS) Nr. 02/2016 për Rregullimin e Strehimit Familjar në Kosovë

<sup>6</sup> Neni 3, pika 1.11, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 02/2016 për Rregullimin e Strehimi Familjar në Kosovë



Figura 16: Fëmijët dhe familjet në strehim familjar brenda familjes biologjike, korrik-shtator 2021




Diferenca e numrit të fëmijëve në strehim familjar brenda familjes biologjike, shtator 2021, me muajin e njëjtë të vitit paraprak është 37 fëmijë më pak apo -8%.

### 3.2.2. Buxheti i shpenzuar, korrik-shtator 2021

Për periudhën korrik-shtator 2021, buxheti i shpenzuar për pagesën e strehimit familjar brenda familjes biologjike, është 131 mijë euro. Në muajin korrik 2021 është procesuar shuma më e madhe e mjeteve. Këtë muaj janë procesuar 43,900 mijë euro apo 34% e totalit të përgjithshëm të buxhetit. Këtë muaj janë procesuar 400 euro apo 1% më shumë se në muajin gusht dhe 300 euro apo 1% më shumë se në muajin shtator 2021. Shih figurën më poshtë:

Figura 17: Buxheti i shpenzuar për strehim familjar brenda familjes, korrik-shtator 2021



Diferenca e buxhetit të shpenzuar korrik-shtator 2021, me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është 12,100 euro më pak apo -8%.


### 3.3. Strehimi familjar jashtë familjes biologjike

**Strehimi familjar jashtë familjes biologjike - nënkupton strehimin e fëmijës në familje alternative që nuk kanë asnjë lidhje farefisnore.**<sup>7</sup> Kjo formë e mbrojtjes sociale iu ofrohet fëmijëve të braktisur e pa kujdes prindëror (fëmijëve të lënë pas dore, të keqtrajtuar, të prindërve të penguar në ushtrimin e detyrës prindërore, apo rasteve të tjera kur cenohet interesi dhe mirëqenia e fëmijës/ve). Pagesa për një fëmijë të vendosur në strehim familjar jashtë familjes është 250 euro në muaj, ndërsa për një fëmijë me nevoja të veçanta, të vendosur në strehim familjar jashtë farefisit është 350 euro në muaj. Në muajin e parë të vendosjes së fëmijës në strehim familjar jashtë farefisit, aplikohet edhe një pagesë fillestare në shumë prej 75 euro. Pagesa bëhet në emër të kujdestarit strehues dhe realizohet përmes llogarive bankare.

#### 3.3.1. Numri i fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes biologjike

Gjatë periudhës raportuese, numri i fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes biologjike nuk ka lëvizur shumë. Në muajin korrik 2021 kemi 55 fëmijë të vendosur në 32 familje strehuese, pra këtë muaj kemi 5 fëmijë më shumë se në muajin korrik dhe në muajin gusht 2021. Shih figurën më poshtë:

Figura 18: Numri i fëmijëve dhe i familjeve strehuese korrik-shtator 2021




Diferenca e numrit të fëmijëve në strehim familjar jashtë familjes biologjike e muajit shtator 2021, me muajin e njëjtë të vitit paraprak është 11 fëmijë më pak apo -18%.

<sup>7</sup> Neni 3, pika 1.12, e Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 02/2016 për Rregullimin e Strehimi Familjar në Kosovë

### 3.3.2. Buxheti i shpenzuar janar-shtator 2019/2018

Për periudhën korrik-shtator 2021, buxheti i shpenzuar për pagesën e Strehimit familjar jashtë familjes biologjike, është 41,450 mijë euro. Në muajin korrik 2021 është procesuar shuma me e madhe e mjeteve. Këtë muaj janë procesuar 14,775 mijë euro apo 36% e totalit të përgjithshëm të buxhetit. Pra, në muajin korrik janë procesuar 1,475 euro më shumë apo 11% se në muajin gusht dhe 1,400 euro më shumë apo 10% se në muajin shtator 2021. Pra në muajin shtator 2021 janë procesuar 1,400 euro më pak se në muajin korrik apo -10%. Shih figurën më poshtë:

Figura 19: Buxheti i shpenzuar për strehim familjar jashtë familjes, korrik-shtator 2021



Diferenca e buxhetit të shpenzuar korrik-shtator 2021, me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është 6,450 euro më pak apo -13%.

## 4. NDIHMAT E NJËHERSHME/EMERGJENTE


### 4.1. Kriteret për përfitimin e ndihmës së njëhershme/emergjente

Bazuar në legjislacionin në fuqi, ndihmë e njëhershme sociale konsiderohet ndihma që ofrohet për individë apo familje për një nevojë momentale, të jashtëzakonshme, por jo edhe të vazhdueshme, siç janë: shpenzimet e varrimit të anëtarëve të familjes, dëmet dhe shkatërrimet e ekonomisë familjare të shkaktuar nga fatkeqësitë elementare (zjarri, tërmeti dhe vërshimi) për humbje të dokumentacionit bashkë me paratë e fundit dhe nevoja të tjera të jashtëzakonshme.<sup>8</sup> Të drejtë aplikimi për përfitimin e ndihmës së njëhershme kanë të gjitha familjet apo individët, pavarësisht se a janë apo nuk janë shfrytëzues të Skemës së Ndhmës Sociale<sup>9</sup>, që i plotësojnë kriteret e parapara për përfitimin e kësaj ndihme. Shuma minimale e pagesës për ndihmë të njëhershme për familjen/ individin është 100 euro dhe aprovohet nga udhëheqësi i DPSF-së, ndërsa shuma maksimale është 300 euro dhe aprovohet nga Ministri i MFPT-së. Pagesa bëhet me para të gatshme, përmes llogarive private bankare, të cilat hapen nga parashtruesi i kërkesës.

### 4.2. Numri i ndihmave të njëhershme të shqyrtuara korrik-shtator 2021

Gjatë periudhës korrik-shtator 2021 janë shqyrtuar 39 kërkesa për ndihmë të njëhershme/emergjente. Në muajin korrik 2021 janë shqyrtuar numri më i madh i kërkesave, 19 kërkesa apo 49% e totalit të përgjithshëm të kërkesave. Këtë muaj janë shqyrtuar 11 kërkesa më shumë se në muajin gusht apo 138% dhe 7 kërkesa më shumë se në muajin shtator apo 58%. Shih figurën më poshtë:

Figura 20: Kërkesat e shqyrtuara për ndihmë të njëhershme, korrik-shtator 2021




<sup>8</sup> Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 12/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Pagesat e Ndhmave të Njëhershme Sociale.

<sup>9</sup> Po aty, neni 5.

Diferenca e numrit të kërkesave të shqyrtuara të periudhës korrik-shtator 2021, me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është 7 kërkesa më shumë apo 22%.

Nga totali prej 39 kërkesave të shqyrtuara, 30 kërkesa apo 77% janë aprovuar, ndërsa 9 kërkesa apo 23% janë refuzuar. Shih figurën më poshtë:

Figura 21: Kërkesat për ndihmë të njehershme të aprovuara/refuzuar, korrik-shtator 2021




Gjatë kësaj periudhe janë aprovuar 6 kërkesa më shumë apo 0.25%, ndërsa është refuzuar 1 kërkesë më shumë apo 0.13% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

#### 4.2.1. Buxheti i shpenzuar janar-shtator 2019/2018

Për periudhën korrik-shtator 2021, buxheti i shpenzuar për ndihma të njehershme është 4 mijë euro. Në muajin korrik 2021 është procesuar shuma më e madhe e mjeteve. Këtë muaj janë procesuar 2,700.00 euro apo 68% e totalit të përgjithshëm të buxhetit të shpenzuar. Pra, në muajin korrik janë procesuar 2,300 euro më shumë apo 575% më shumë se në muajin gusht dhe 1,800 euro më shumë apo 200% më shumë se në muajin shtator 2021. Pra, në muajin shtator 2021 janë procesuar 1,800 euro më pak se në muajin korrik apo -200%. Shih figurën më poshtë:

Figura 22: Buxheti i shpenzuar për Ndhim të njehershme, korrik-shtator 2021



Diferenca e buxhetit të shpenzuar gjatë muajve korrik-shtator 2021, me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është 1,100 euro më shumë apo 38%.

## PËRMBLEDHJE ME TË DHËNA TË PËRGJITHËSHME

	Shtator 2021	Shtator 2020	Diferenca në %
<b>Numri i familjeve në Skemën e Ndhmës Sociale (shtator)</b>	<b>25,514</b>	<b>24,496</b>	<b>4.00%</b>
Shuma minimale mujore e ndihmës sociale (familja me 1 anëtar)	60.00 €	60.00 €	0%
Shuma maksimale mujore e ndihmës sociale (familja me 15 anëtarë)	180.00 €	180.00 €	0%
Shtesa mujore për çdo fëmijë të moshës 0-18 vjeç	5.00 €	5.00 €	0%
Mjetet e procesuara për muajin shtator	3,400,056.50 €	2,589,490.00 €	31%
Buxheti i shpenzuar	10,224,710.25 €	7,729,677.50 €	32
<b>Numri i fëmijëve përfitues të Skemës së FFAKP-së (shtator)</b>	<b>2,521</b>	<b>2,333</b>	<b>8%</b>
Shuma mujore për një fëmijë përfitues i Skemës së FFAKP-së	100.00 €	100.00 €	0%
Mjetet e procesuara për muajin shtator	253,100.00 €	233,300.00 €	8.00%
Buxheti i shpenzuar janar-shtator	791,700.00 €	722,900.00 €	10.00%
<b>Fëmijët në strehim familjar brenda familjes biologjike (shtator)</b>	<b>436</b>	<b>473</b>	<b>-8%</b>
Numri i familjeve strehuese	318	341	-7%
Shuma mujore për 1 fëmijë në strehim familjar brenda familjes biologjike	100.00 €	100.00 €	0%
Mjetet e procesuara për muajin shtator	43,600.00 €	47,600.00 €	-8%
Buxheti i shpenzuar korrik-shtator	143,100.00 €	151,700.00 €	-6%
<b>Fëmijët në strehim familjar jashtë familjes biologjike (shtator)</b>	<b>50</b>	<b>61</b>	<b>-18%</b>
Numri i familjeve strehuese	30	30	0%
Shuma mujore për 1 fëmijë në strehim familjar jashtë familjes biologjike	250.00 €	250.00 €	0%
Shuma mujore për 1 fëmijë me aftësi të kufizuara në strehim familjar jashtë familjes biologjike	350.00 €	350.00 €	0%
Shuma e mjeteve të procesuara për muajin shtator	13,375.00 €	16,300.00 €	-18%
Buxheti i shpenzuar janar-shtator	41,450.00 €	47,900.00 €	-13%
<b>Numri i kërkesave të shqyrtuara për ndihmë të njëhershme</b>	<b>39</b>	<b>32</b>	<b>22%</b>
Numri i kërkesave të aprovuara (100-300 euro)	30	24	25%
Numri i kërkesave të refuzuara	9	8	13%
Shuma e mjeteve të procesuara për muajin shtator	900.00 €	2,900.00 €	-69%
Buxheti i shpenzuar janar-shtator	4,000.00 €	2,900.00 €	38%

Tetor, 2021